REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS

Nr ._____ prot. **Prrenjas, më ___.___.2026**

RAPORT

MBI KONSULTIMIN PUBLIK PËR REFORMËN ADMINISTRATIVE TERRITORIALE 2.0

1. Hyrje

Kuvendi i Shqipërisë, me shkresën nr. 3573, datë 31.07.2026, të protokolluar pranë institucionit tonë me nr. 1881, datë 03.08.2026, i ka dërguar Bashkisë Prrenjas projektligjin "Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë".

Në projektligjin e propozuar parashikohet ndryshimi i organizimit administrativ-territorial, konkretisht shkrirja e Bashkisë Prrenjas dhe bashkimi i saj me Bashkinë Librazhd.

Në përputhje me nenet 89 dhe 90 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, Këshilli Bashkiak dhe Bashkia Prrenjas ndërmorën masat për informimin dhe konsultimin e popullsisë, nëpërmjet organizimit të dëgjesave publike lidhur me projektligjin e propozuar.

Në kuadër të këtij procesi u zhvillua konsultimi dhe informimi i komunitetit për Reformën Administrative Territoriale 2.0, duke organizuar dëgjesa publike në njësitë administrative të

Bashkisë Prrenjas, me synim përfshirjen e qytetarëve në diskutimin mbi procesin e reformës, si dhe mbledhjen e mendimeve, sugjerimeve dhe problematikave të evidentuara në komunitet.

Procesi u zhvillua në përputhje me Njoftimin dhe Kalendarin e Konsultimit Publik, të publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Prrenjas si edhe draftin e këtij projektligji.

https://www.bashkiaprrenjas.gov.al/notices/njoftim-per-konsultim-publik-4/.

Nr	Aktiviteti	Data	Vendi	Ora	Mënyra	Forma
1.	Konsultim publik me banorë, biznese, fermere, mësues, grupe vulnerabel, etj, Njësia Administrative **Qukës.**	08/09/2026	Njësia Adm Qukës Pranë shkollës "Dilaver Nezha"	17:00	Takim publik	Diskutime te hapura
2.	Konsultim publik me banorë, biznese, fermere, mësues, grupe vulnerabel, etj te Njësia Administrative **Rrajcë**	09/09/2026	Njësia.Adm Rrajce pranë shkollës 9-vjeçare	17:00	Takim publik	Diskutime te hapura
3.	Konsultim publik me banorë, biznese, fermere, mësues, grupe vulnerabel, etj ne Njesia Administrative **Stravaj**.	09/09/2026	Njësia Adm Stravaj pranë shkollës "Ahmet Elezi"	11:00	Takim publik	Diskutime te hapura
4.	Konsultim publik me banorë, biznese, fermere, OJF, mësues, grupe vulnerabel, etj, ne **Qytetin Prrenjas**.	10/09/2026	Prrenjas Qendra kulturore	18:00	Takim publik	Diskutime te hapura
5.	Konsultim me biznese të zonës, mësues, intelektualë, mjekë, infermierë të zonës.	10/09/2026	Salla e Keshillit	09:00	Takim publik	Diskutime te hapura
6.	Konsultim publik me prindërit e fëmijëve me PAK	11/09/2026	Qendra me multifunk sionale	09:00	Takim publik	Diskutime te hapura
7.	Konsultim me Këshillin Rinor Prrenjas	11/09/2026	Salla e Keshillit	12:00	Takim publik	Diskutime te hapura

Dëgjesat kanë shërbyer si një mundësi për komunikim të drejtpërdrejtë me qytetarët dhe për evidentimin e qëndrimeve të tyre lidhur me organizimin administrativ dhe territorial të këtij projektligji.

2. Zhvillimi i dëgjesave publike

Dëgjesat publike u zhvilluan në të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Prrenjas, si dhe në qytetin e Prrenjasit, duke krijuar mundësi për pjesëmarrjen e banorëve dhe aktorëve të ndryshëm të komunitetit në procesin e konsultimit.

Në takime morën pjesë qytetarë, përfaqësues të Këshillit Bashkiak, përfaqësues të Bashkisë, deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, përfaqësues të biznesit, intelektualë, prindër, mesues, prindër të PAK të rinj grupe të tjera të interesit.

- Dëgjesa në Njësinë Administrative Qukës

Dëgjesa e parë u zhvillua në Njësinë Administrative Qukës, më 08.09.2026, ora 17:00. Në takim pati pjesëmarrje nga përfaqësues të Këshillit Bashkiak si edhe bashkisë Prrenjas. Në total morën pjesë 101 qytetarë, nga të cilët:

- 19 femra;
- 82 meshkuj.

Gjatë takimit qytetarët paraqitën mendimet, shqetësimet dhe rekomandimet e tyre lidhur me projektligjin. Nga diskutimet e zhvilluara u evidentua qëndrimi i qytetarëve kundër shkrirjes së Bashkisë Prrenjas dhe bashkimit të saj me Bashkinë Librazhd. Referuar listëprezencës dhe pyetjes së parashtruar lidhur me qëndrimin pro ose kundër bashkimit të Bashkisë Prrenjas me Bashkinë Librazhd, rezulton se, nga 101 persona të pyetur, 100 persona janë shprehur kundër bashkimit**,** ndërsa 1 person është shprehur pro bashkimit**.**

Në total në Nj.A. që u dhanë rekomandime dhe sygjerime duke argumentuar ishin 12 persona.

- Dëgjesa në Njësinë Administrative Stravaj

Dëgjesa e dytë u zhvillua në Njësinë Administrative Stravaj, më 09.09.2026, ora 11:00, me pjesëmarrjen e anëtarëve të Këshillit Bashkiak dhe të bashkisë Prrenjas si dhe deputetit të zonës, Olsi Komici.

Në takim morën pjesë gjithsej 46 persona, nga të cilët:

- 12 femra;
- 34 meshkuj.

Gjatë dëgjesës u paraqitën mendime dhe rekomandime lidhur me projektligjin, ndërsa nga diskutimet u evidentua kundërshtimi ndaj propozimit për shkrirjen e Bashkisë Prrenjas dhe bashkimin e saj me Bashkinë Librazhd. Ndërsa Referuar listëprezencës dhe pyetjes së parashtruar lidhur me qëndrimin pro ose kundër bashkimit të Bashkisë Prrenjas me Bashkinë Librazhd, rezulton se, nga 46 persona të pyetur, 45 persona janë shprehur kundër bashkimit**,** ndërsa 1 person është shprehur pro bashkimit. U paraqitën rekomandime dhe sygjerime të argumentuara nga 9 persona.

- Dëgjesa në Njësinë Administrative Rrajcë

Dëgjesa e tretë u zhvillua në Njësinë Administrative Rrajcë, më 09.09.2026, ora 17:00.

Në takim morën pjesë përfaqësues të Këshillit Bashkiak dhe të bashkisë Prrenjas, si dhe deputetët Olsi Komici dhe Bora Muzhaqi, si dhe përfaqësuesja e Partisë Demokratike, Klodiana Çapja.

Në dëgjesë morën pjesë gjithsej 93 banorë, nga të cilët:

- 22 femra;
- 71 meshkuj.

Takimi u shoqërua me diskutime të shumta dhe me shprehjen e qëndrimeve të qytetarëve lidhur me projektligjin. Gjatë dëgjesës qytetarët u shprehën kundër shkrirjes së Bashkisë Prrenjas, duke

paraqitur shqetësimet dhe argumentet e tyre lidhur me propozimin për ndryshimin e ndarjes administrative-territoriale. Ndërsa referuar listëprezencës dhe pyetjes së parashtruar lidhur me qëndrimin pro ose kundër bashkimit të Bashkisë Prrenjas me Bashkinë Librazhd, rezulton se, nga 93 persona të pyetur, të gjithë janë shprehur kundër bashkimit**.** Diskutuan dhe argumentuan 10 persona duke shprehur dhe mendimin kundër shkrirjes.

- Dëgjesa në qytetin e Prrenjasit

Dëgjesa publike në qytetin e Prrenjasit u zhvillua më 10.09.2026, ora 18:00.

Në kuadër të këtij takimi u përfshinë edhe kategori të ndryshme të komunitetit, ndër të cilat intelektualë, përfaqësues të biznesit, grupe prindërish dhe persona me aftësi të kufizuara.

Ky organizim u bë me qëllim lehtësimin e pjesëmarrjes së qytetarëve, duke marrë në konsideratë faktin se gjatë orëve të paradites një pjesë e konsiderueshme e qytetarëve ndodhen në punë. Ndryshimi i kalendarit u publikua edhe në faqen e Këshillit Bashkiak në Facebook.

Në takim morën pjesë deputeti Olsi Komici, deputetët Blendi Himçi dhe Klodiana Çapja, si dhe përfaqësues të Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak.

Në total morën pjesë rreth 106 persona, nga të cilët:

- 24 femra;
- 82 meshkuj.

Edhe në këtë takim u evidentua një reagim i fortë i qytetarëve lidhur me propozimin për shkrirjen e Bashkisë Prrenjas. Qytetarët shprehën kundërshtimin e tyre ndaj shkrirjes së bashkisë dhe bashkimit të saj me Bashkinë Librazhd, duke paraqitur shqetësimet dhe sugjerimet e tyre. referuar listëprezencës dhe pyetjes së parashtruar lidhur me qëndrimin pro ose kundër bashkimit të Bashkisë Prrenjas me Bashkinë Librazhd, rezulton se, nga 106 persona të pyetur, të gjithë janë shprehur kundër bashkimit**.**

- Takimi me Këshillin Rinor

Në kuadër të procesit të konsultimit publik u zhvillua gjithashtu një takim me Këshillin Rinor, me qëllim përfshirjen e të rinjve në procesin e konsultimit për Reformën Administrative Territoriale 2.0.

Në këtë takim morën pjesë gjithsej 14 të rinj, nga të cilët:

- 10 femra;
- 4 meshkuj.

Takimi me Këshillin Rinor krijoi një hapësirë të veçantë për dëgjimin e zërit të të rinjve dhe për marrjen e mendimeve dhe sugjerimeve të tyre lidhur me projektligjin dhe propozimin për ndryshimin e ndarjes administrative-territoriale. Të rinjtë argumentuan seishin kundër shkrirjes së bashkisë Prrenjas, nga listëprezenca 14 të gjithë ishin kundër kësj reforme.

3. Përmbledhja e pjesëmarrjes

Në total, në të gjitha dëgjesat dhe takimet e zhvilluara në kuadër të procesit të konsultimit publik morën pjesë rreth 360 persona.

Njësia / takimi	Data	Femra	Meshkuj	Totali
Nj.A. Qukës	08.09.2026	19	82	101
Nj.A. Stravaj	09.09.2026	12	34	46
Nj.A. Rrajcë	09.09.2026	22	71	93
Qyteti Prrenjas	10.09.2026	24	82	106
Këshilli Rinor	11.09.2026	10	4	14
TOTAL		87	273	360

Nga totali prej 360 pjesëmarrësish, 87 kanë qenë femra, ndërsa 273 kanë qenë meshkuj.

4. Sugjerimet dhe qëndrimet e qytetarëve

Gjatë dëgjesave publike dhe takimeve të zhvilluara, qytetarëve iu dha mundësia të paraqisnin mendimet, sugjerimet, rekomandimet dhe shqetësimet e tyre lidhur me projektligjin "Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë".

Nga diskutimet e zhvilluara në Njësinë Administrative Qukës, Njësinë Administrative Stravaj, Njësinë Administrative Rrajcë dhe qytetin e Prrenjasit, u evidentua një qëndrim i përsëritur i qytetarëve kundër shkrirjes së Bashkisë Prrenjas dhe bashkimit të saj me Bashkinë Librazhd.

Qytetarët paraqitën shqetësimet dhe argumentet e tyre lidhur me ruajtjen e Bashkisë Prrenjas si njësi e vetëqeverisjes vendore, si dhe me ndikimin që ndryshimi i propozuar mund të ketë, sipas tyre, në administrimin vendor dhe ofrimin e shërbimeve publike.

Këto qëndrime dhe rekomandime janë evidentuar gjatë takimeve dhe përbëjnë pjesë të dokumentacionit të procesit të konsultimit publik.

5. Pjesëmarrja përmes Google Forms

Krahas dëgjesave dhe takimeve fizike, si një mënyrë shtesë për përfshirjen e qytetarëve në procesin e konsultimit publik është përdorur edhe platforma Google Forms.

Përmbledhje e rezultateve të pyetësorit

Në kuadër të procesit të mbledhjes së opinioneve të qytetarëve, nëpërmjet platformës Google Forms janë administruar gjithsej 40 aplikime. Rezultatet e pyetësorit paraqesin të dhëna mbi profilin e pjesëmarrësve, lidhjen e tyre me Bashkinë Prrenjas, si dhe perceptimin e tyre lidhur me organizimin territorial dhe afërsinë e institucioneve dhe shërbimeve publike me qytetarët.

a. Banimi në Bashkinë Prrenjas

Nga 40 pjesëmarrësit, 92.5% janë shprehur se janë banorë të Bashkisë Prrenjas, ndërsa 7.5% janë përgjigjur se nuk janë banorë të kësaj bashkie.

b. Gjinia e pjesëmarrësve

Në lidhje me gjininë, 62.5% e pjesëmarrësve janë femra, ndërsa 37.5% janë meshkuj. Kjo tregon një pjesëmarrje më të lartë të femrave në plotësimin e pyetësorit.

c. Ndikimi i ndryshimit të organizimit territorial

Pyetjes nëse mendojnë se ndryshimi i organizimit territorial do të ndikonte pozitivisht në Bashkinë Prrenjas, 87.5% e pjesëmarrësve janë përgjigjur "Jo", ndërsa 10% janë përgjigjur "Po". Pjesa e mbetur, 2.5%, është shprehur se "Nuk e di".

Këto të dhëna tregojnë se pjesa dërrmuese e pjesëmarrësve nuk e percepton ndryshimin e organizimit territorial si një faktor që do të ndikonte pozitivisht në Bashkinë Prrenjas.

d. Rëndësia e afërsisë së institucioneve dhe shërbimeve publike

Në pyetjen se sa e rëndësishme është që institucionet dhe shërbimet publike të jenë pranë qytetarëve, 95% e pjesëmarrësve e kanë vlerësuar këtë si "Shumë të rëndësishme".

e. Përfundim

Në tërësi, rezultatet e pyetësorit evidentojnë një vlerësim të lartë të rëndësisë së afërsisë së institucioneve dhe shërbimeve publike me qytetarët, ndërkohë që një pjesë shumë e madhe e pjesëmarrësve nuk mendon se ndryshimi i organizimit territorial do të sillte ndikim pozitiv për Bashkinë Prrenjas. Duke qenë se 92.5% e të anketuarve janë banorë të Bashkisë Prrenjas, rezultatet ofrojnë një pasqyrë të opinionit të pjesëmarrësve që lidhen drejtpërdrejt me territorin e

kësaj bashkie. Nëpërmjet formularit online janë regjistruar rreth 40 aplikime, duke krijuar një kanal shtesë për ata që nuk kanë mundësinë për shprehjen e interesit dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e konsultimit. Përdorimi i kësaj forme të komunikimit ka mundësuar zgjerimin e pjesëmarrjes dhe mbledhjen e të dhënave në mënyrë elektronike.

6. Përfundime

Procesi i konsultimit publik për Reformën Administrative Territoriale 2.0 u zhvillua në njësitë administrative të Bashkisë Prrenjas, në qytetin e Prrenjasit, si dhe përmes një takimi të veçantë me Këshillin Rinor.

Në total, në dëgjesa dhe takime morën pjesë rreth 360 persona, prej të cilëve 87 femra dhe 273 meshkuj. Gjithashtu, nëpërmjet platformës Google Forms janë regjistruar rreth 40 aplikime.

Procesi i konsultimit mundësoi përfshirjen e kategorive të ndryshme të komunitetit, duke përfshirë banorët e njësive administrative, të rinjtë, përfaqësuesit e biznesit, intelektualët, prindërit dhe personat me aftësi të kufizuara.

Nga dëgjesat dhe diskutimet e zhvilluara në njësitë administrative dhe në qytetin e Prrenjasit u evidentua si qëndrim i përsëritur kundërshtimi i qytetarëve ndaj propozimit për shkrirjen e Bashkisë Prrenjas dhe bashkimin e saj me Bashkinë Librazhd. Të gjitha mendimet, sugjerimet, shqetësimet dhe rekomandimet e paraqitura gjatë këtij procesi do të pasqyrohen në dokumentacionin përfundimtar të konsultimit publik dhe do të përcillen në kuadër të procesit institucional për Reformën Administrative Territoriale 2.0.

Konceptoi: Koordinator për Njoftim dhe Konsultim Publik
Rudina Kukli